

UDHËZIM
Nr.38, datë 21.11.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET KONSULLORE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME APO TË AMBASADAVE TONA JASHTË VENDIT
DHE TARIFA PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE TË UDHËTIMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 e Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit vilen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet e tjera në varësi të tyre, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

2. Tarifat për pajisjen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, vilen nga Ministria e Brendshme apo drejtoritë/degët në varësi të tyre, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

3. Shtetasit që pajisen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, përveç pagimit të vlerës së pasaportës, do të paguajnë edhe tarifën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

4. Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të shtojcës nr.1, niveli i tarifës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, dollarë ose në monedhen e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit.

5. Tarifat e arkëtuara brenda vendit derdhen brenda ditës në llogarinë bankare të thesarit për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme. Përfaqësitë tona diplomatike raportojnë çdo muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi tarifën e arkëtuara prej tyre. Ministria e Punëve të Jashtme transferon në fund të muajit në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit shumën totale të tarifave sipas raportimit të bërë nga përfaqësitë tona diplomatike. Çdo muaj Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme (apo institucionet në varësi të tyre) rakordojnë me degët respektive të thesarit.

Shuma e tarifave të arkëtuara sipas këtij udhëzimi, i takojnë 100% Buxhetit të Shtetit.

6. Me termin “përfaqësi” kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Tarifat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse.

7. Për vjeljen e tarifave konsullore me anën e pullës, Ministria e Punëve të Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Lulzim Basha

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

SHTOJCA NR.1
TARIFAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

I. Tarifat për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit:		
1. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit 2000 lekë;		
2. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit nga përfaqësitë 50 euro;		
3. Zgjatja e pasaportës nga përfaqësitë euro;	15	
4. Për lejkalimi 200 lekë;		
5. Lejkalimi lëshuar nga përfaqësitë euro.	30	
II. Tarifat për lëshimin, verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve:		
1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë euro;	30	
2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;		
3. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë euro;	30	
4. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;		
5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë euro;	10	
6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga Ministria e Punëve të Jashtme lekë;	200	
7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 20 euro;		
8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huaj reciprocitet.		
III. Tarifat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë.		
1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga përfaqësitë euro/faqe;	20	
2. Vërtetimi i dublikatave dhe kopjeve euro/faqe;	20	
3. Përkthimi i dokumenteve euro/faqe.	10	

Shënim: Me termin “përfaqësi” kuptohet përfaqësia diplomatike ose konsullore jashtë shtetit.
Tarifa mund të arkëtohet edhe në dollarë ose në monedhën e vendit, duke pasur parasysh kursin e këmbimit.